



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic Of Kosova
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastruktërës
Ministarstvo Životne Sredine, Prostornog Planiranja i Infrastrukture
Ministry of Environment, Spatial Planning and Infrastructure



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic Of Kosova

Komuna e Malishevës
Opština Malisevo
Municipality of Malisheva

NJOFTIM

THIRRJE PUBLIKE PËR SHPREHJE TË INTERESIT PËR NËN-PROJEKTIN:

RENOVIMI / RINDËRTIMI I SHTËPIVE PRIVATE PËR FAMILJET E CENUESHME NË KUADËR TË PROJEKTIT “BANIMI SOCIAL ADEKUAT”

Komuna e Malishevës njofton hapjen e Thirrjes Publike për Shprehje të Interesit për nën-projektin **“Renovimi/Rindërtimi i shtëpive private për familjet e cenueshme”** në kuadër të Projektit “Banimi Social Adekuat”. Nën-projekti synon të renovojë/rindërtojë shtëpitë ekzistuese në pronësi të familjeve të cenueshme, të varfra deri në ato me të ardhura më të ulëta, për t’i bërë ato të përshtatshme për jetesë dhe më eficiente në energji.

Projekti për Banim Social Adekuat në Republikën e Kosovës do të zbatohet nga Ligji Nr.08/L-302 për Ratifikimin e Marrëveshjes së Kredisë në mes të Republikës së Kosovës përfaqësuar nga Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve (MPFT) dhe Bankës Zhvillimore të Këshillit të Evropës (BZHKE) për projektin “Banimi Social Adekuat”. Kredia nga BZHKE me vlerë totale prej 25 milion euro, do t’i jepet si financim Komunave të Republikës së Kosovës, së bashku me kontribut nga MMPHI prej 12 milion euro, të rrisë numrin e njësive të banimit social dhe të përmirësojë kushtet e jetesës për familjet me të ardhura të ulëta deri të mesme.

Ky Projekt ofron mundësi për Komunat që të përfitojnë financim nga MMPHI për realizimin e projekteve për Banim Social Adekuat, përfshirë nën-projektin e rinovimit/ rindërtimit të shtëpive private. Financimi i nën-projektit do të mbulojë kostot për renovimin apo rindërtimin e shtëpive private duke përmirësuar kështu kushtet e jetesës për familjet e cenueshme që përballen me vështirësi ekonomike dhe që nuk mund të përmbushin nevojat bazë për banim.

KUSH KA TË DREJTË TË APLIKOJË

Të drejtë aplikimi kanë familjet apo individët që janë shtetas të Republikës së Kosovës, që kanë mbetur ose rrezikojnë të mbeten pa e zgjidhur çështjen e banimit si rezultat i një ose më shumë faktorëve, siç janë:

1. Dëmtimit të shtëpisë private që nuk i plotëson kushtet dhe është nën normat minimale të banimit për të qenë njësi banimi;
2. Rrezikut të shkatërrimit për shkak të vjetërisë së saj;
3. Zhvendosjes për shkak të investimeve publike apo për shkak të prishjes së shtëpisë private që nuk i plotëson kushtet për t'u legalizuar;
4. Pamundësisë së pagesës së qirasë me kushtet e tregut;
5. Familje apo individ pa përkujdesje;
6. Fatkeqësive natyrore dhe fatkeqësive të shkaktuara nga njeriu;
7. Dëmtimit të shtëpisë private, njësisë së banimit gjatë luftës së vitit 1998/1999;
8. Rrethanave tjera të cilat Komunitat i konsiderojnë relevante në kontekstin lokal.

SI TË APLIKOHET

Njoftimi për Thirrje Publike për Shprehje të Interesit është i publikuar në web faqen e Komunës dhe në platforma tjera (rrjete sociale, TV lokal, radio, etj), së bashku me të gjitha informatat e nevojshme dhe formularët për aplikim në këtë thirrje publike.

Shprehja e Interesit bëhet duke tërhequr Formularin e Aplikimit pranë Komunës suaj apo duke e shkarkuar atë nga web faqja e Komunës. Formulari plotësohet dhe dorëzohet fizikisht pranë Komunës, duke bashkëngjitur edhe dokumentet e mëposhtme.

DOKUMENTET QË DUHET TË BASHKËNGJITEN

1. Formularin e aplikimit të marrë në Komunë apo të shkarkuar nga web faqja e Komunës, të plotësuar më të gjitha të dhënat (e nënshkruar nga ana e aplikuesit);
2. Kopjen e Letër-njoftimit të aplikuesit;
3. Deklaratë për bashkësinë familjare;
4. Certifikatën apo dokumentet që dëshmojnë njëërën apo më shumë nga (16) kategoritë e listuara më poshtë;
5. Certifikatën e pronësisë (fletën poseduese të pronës – jo më e vjetër se 6 muaj) ose dokument i noterizuar mbi disponueshmërinë e pronës;
6. Vendimi mbi posedimin e Lejes Ndërtimore të shtëpisë, legalizimit, apo dëshmisë se shtëpia është në proces të legalizimit;
7. Fatura e tatimit në pronë për vitin 2025 e gjeneruar nga e-Kosova.

PERIUDHA E APLIKIMIT

Thirrja për Shprehje të Interesit do të jetë e hapur nga data **30.07.2025** deri me datë **15.08.2025**.

Formulari i plotësuar i shprehjes së interesit së bashku me të gjithë dokumentacionin e bashkëngjitur, dorëzohen në formë fizike në ndërtesën e Komunës **Zyra Pritëse e Palëve**, çdo ditë pune nga ora 08:00 hderi në ora 16:00 h.

Dorëzimi bëhet në zarf të mbyllur, në të cilin shkruhet:

- Emri i Aplikimit: **Renovimi / Rindërtimi i shtëpive private për familjet e cënueshme**
- Emri dhe Mbiemri i Aplikuesit:
- Adresa e Aplikuesit:
- Data e aplikimit:

Gjithashtu informacione dhe sqarime shtesë mund të merren tek – Njësiti i Implementimit të Projektit të Banimit Social Adekuat të Komunës:

- a) Drejtoria e Shërbimeve Publike .
- b) Drejtoria e Urbanizmit.